



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:015358
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05611996

C.A.nr.4065/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi-Alaj, dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të propozueses të masës së sigurimit N.E., me vendbanim në Londër, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.I., avokat me seli në Komuna Prishtinë, kundër kundërshtarit të sigurimit R.I., nga Komuna Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.P., avokat me seli në Komuna Prishtinë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga propozuesi i masës së sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.5042/23 datë 07.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e propozueses së masës së sigurimit N.E., me vendbanim në Londër, dhe **VËRTETOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.5042/23 datë 07.12.2023.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar C.nr.5042/23 datë 07.12.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. REFUZOHET si i bazuar propozimi për caktimin e masës së sigurimit i propozueses së sigurimit N.E., me vendbanim në Londër me të cilën ka kërkuar të caktohet masa e sigurimit me të cilën i NDALOHET kundërshtarit të sigurimit R.I. nga Prishtina, shitblerja, bartja e pasurisë, fshehja, ngarkimit apo disponimit tjetësimi apo ndërmarrja e ndonjë veprimi tjetër në paluajtshmerinë që evidentuar si ngastër kadastrale: P-719140075-00766-20: P-719140075-00766-25: P-719140075-00766-27: P-719140075-00766-28, do t'ZK Çagllavicë, Komuna e Prishtinës.

II. ANULOHET aktvendimi i kësaj gjykate i evidentuar i kësaj gjykate i evidentuar sipasa shenjës C.nr.365/23 i datës 10.07.2023 me të cilën është caktuar masa e sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit R.I. nga Prishtina, në ngastrat kadastrale si në pikën –I- të dispozitivit të këtij aktvendimi, të caktuar sipas aktvendimit të kësaj gjykate të evidentuar sipas shenjës C.nr.365/23 të datës 10.07.2023.

III. Ky aktvendim do t'i dërgohet menjëherë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Prishtinës, Odës së Noterëve dhe palëve ndërgjyqëse.

IV. Procedura në këtë çështje juridike-kontestimore, do të vazhdojë sipas rregullave të procedurës kontestimore dhe sipas planit të gjykatës...”.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të paraparë ligjor ka parashtruar ankesë propozuesja e masës së sigurimit, përmes të autorizuarit, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovohet si e bazuar ankesa e propozueses dhe anulohet aktvendimi i atakuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit/ve 194, dhe nenit 209 pika b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se propozuesja e masës së sigurimit N.E., me vendbanim në Londër, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.I., avokat me seli në Komuna Prishtinë, ka paraqitur propozim, kundër kundërshtarit të sigurimit R.I., nga Komuna Prishtinë, me kërkesë për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata Themelore në Prishtinë, ka nxjerrë aktvendim C.nr.365/23 datë 10.07.2023, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë.

Kundër aktvendimit C.nr.365/23 datë 10.07.2023, ka paraqitur ankesë kundërshtari i sigurimit për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, ka nxjerrë aktvendim A.C.nr.5317/2023 datë 07.09.2023, me të cilin ka vendosur që të aprovohet ankesa si e themeltë e kundërshtarit të masës së sigurimit, dhe lëndën e ka kthyer në procedim të serishëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas kthimit të lëndës në procedim të serishëm, me datë 07.12.2023, ka marrë aktvendim C.nr.5042/23 datë 07.12.2023, me të cilin e ka e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ndër të tjera ka arsyetuar se: *“... propozimi për caktimin e masës së sigurimit nuk është i bazuar për faktin se nuk plotësohen kushtet ligjore në mënyrë kumulative nga dispozita e nenit 297 të LPK-së, ngase të drejtën subjektive të cilën propozuesja e mbështet në cilësinë e trashëgimtares së domesdoshme me pretendimin e cenimit të pjesës së domesdoshme, nuk mund të jetë çështje shqyrtimi në këtë fazë të procedurës, andaj rrjedhimisht as vlerësimi i rrezikshmërisë që mund të vie si pasojë e cenimit të kësaj të drejte të pretenduar... gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, kur ka anuluar vendimin e mëparshëm C.nr.365/23 të datës 10.07.2023 me të cilën është caktuar masa e sigurimit për ngastrat kadastrale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në nenin 297 par.1, pika a) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore ndër të tjera thuhet se *“...masa e sigurimit mund të caktohet në rast se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive...”*, ndërsa në pikën b) ndër të tjera thuhet se *“... duhet të vërtetohet se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar pala kundërshtarë do ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, e sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*.

Kushtet ligjore të rregulluara me nenin 297 par.1 pika a) dhe b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, duhet të përmbushen e pastaj të caktohet masa e sigurimit, ndërsa në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 297 par.1 pika a) dhe b) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Pretendimet ankimore janë në tërësi të pa themelta dhe të pa bazuara me prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës, dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaftë i kjuarë dhe i kuptueshëm, dhe se pretendimet ankimore kryesisht janë pretendime që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, lidhur me vendosjen për kërkesëpadinë, dhe të njëjtat nuk kanë ndonjë rëndësi sa i përket vendosjes për propozimin për masën e

sigurisë, dhe janë në tërësi të pa bazuara me prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 209 pika b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
C.A.nr.4065/2024 datë 23.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi